



AVOKATI I POPULLIT MBROJTËS I TË DREJTAVE TË FËMIJËVE



KONTAKTI:

Avokatit të Popullit mund t'i drejtoheni çdo ditë pune nga ora 08:00 deri më 16:00

Përmes telefonit dhe faksit në:

Shkup: tel. 02/ 3129-335 / faks. 02/ 3129-359
Strumicë: tel. 034/ 329-996 / faks. 034/ 329-997
Kërçovë: tel. 045/ 228-586 / faks. 045/ 228-584
Tetovë: tel. 044/ 344-082 / faks. 044/ 344-083
Manastir: tel. 047/ 242-310 / faks. 047/ 242-510
Shtip: tel. 032/ 389-701 / faks. 032/ 389-700
Kumanovë: tel. 031/ 431-488 / faks. 031/ 431-520

Përmes postës ose personalisht në:

Shkup: rr."Dimitrija Çupovski"nr. 2 (objekti i NN "Pellagonia")
Strumicë: rr."Ballkanska" nr.18 (objekti i EVN Maqedoni)
Kërçovë: rr."Bulevardi Osloboduvanje", p.n.
Tetovë: rr."Ilindenska" nr. 85
Manastir: rr."Jane Sandanski" p.n. (objekti i "Kjubi Makedonia")
Shtip: rr."Tosho Arsov" p.n. (objekti i "Kjubi Makedonia")
Kumanovë: rr."11 Oktomvri" p.n. (objekti i Postave të Maqedonisë)

Posta elektronike: contact@ombudsman.mk

Ueb faqja: www.ombudsman.mk

SI T'I DREJTOHENI AVOKATIT TË POPULLIT?

Nëse keni nevojë për ndihmën e Avokatit të Popullit, mund të drejtoheni personalisht në zyrën e Avokatit të Popullit në Shkup, si dhe në zyrat rajonale në: Tetovë, Kërçovë, Shtip, Strumicë, Kumanovë dhe Manastir, me telefon, postë, telefaks ose përmes postës elektronike.

Gjuha nuk paraqet pengesë për komunikim me Avokatit të Popullit. Me të mund të komunikoni në cilëndo gjuhë dhe alfabet. Avokati i Popullit përgjigjet në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik, si dhe në gjuhën dhe alfabetin zyrtar që e përdor parashtruesi i parashtrësës.

ÇKA MUND TË BËJË AVOKATI I POPULLIT?

Avokati i Popullit dërgon rekomandime, mendime, sugjerime pranë organeve të administratës shtetërore dhe organeve e organizatave me autorizime publike. Organet duhet t'i respektojnë rekomandimet, mendimet dhe sugjerimet e Avokatit të Popullit sepse për mosveprimin e tyre Avokati i Popullit e informon ministrin, Qeverinë, Kuvendin, si dhe e ekspozon në kritikë publike çdo organ kompetent ose person zyrtar që ka bërë shkeljen e të drejtës së qytetarit.

ÇKA NUK MUND TË BËJË AVOKATI I POPULLIT?

Avokati i Popullit nuk mund ta zëvendësojë gjykatën. Ai nuk ka të drejtë të dënojë dhe të ndryshojë vendime gjyqësore.

ÇKA PAS PARASHTRIMIT TË PARASHTRËSËS?

Nëse vlerëson se parashtrësja ka bazë Avokati i Popullit hap procedurë, për rrjedhën e së cilës e informon parashtruesin, por nëse parashtrësja nuk ka bazë e njëjta hidhet poshtë.

Veprimi i Avokatit të Popullit sipas parashtrësave të parashtruara bëhet falas.

AVOKATI I POPULLIT
rr."Dimitrija Çupovski" nr. 2
1000 SHKUP



Република Македонија
НАРОДЕН ПРАВОБРАНИТЕЛ
Republika e Maqedonisë
AVOKATI I POPULLIT
OMBUDSMAN
Republic of Macedonia

PARASHTRËSË

TË DHËNAT E PARASHTRUESIT

EMRI DHE MBIEMRI

VENDI I LINDJES

ADRESA

TELEFONI

PËRKATËSIA E BASHKËSISË ETNIKE

GJINIA: M F

MOSHA

PROFESIONI

SHTETAS

ORGANI APO ORGANIZATA ME TË CILËN KA TË BËJË PARASHTRËSJA

EMRI, MBIEMRI DHE FUNKSIONI I PERSONIT ZYRTAR I CILI KA BËRË SHKELJE TË TË DREJTËS SË PARASHTRUESIT

NË VAZHDIM JEPNI TË DHËNA PËR AKTIN (VENDIMIN, PËRFUNDIMIN ETJ ME TË CILIN U ËSHTË SHKELUR E DREJTA OSE BËNI PËRSHKRIMIN E VEPRIMIT ME TË CILIN U ËSHTË BËRË SHKELJA E TË DREJTAVE

Fëmijët i kanë të drejtat e tyre, fëmijë është çdo qenie njerëzore e cila ka më pak se 18 vjet. Si fëmijë duhet ta dish se:

Respektimi i të drejtave tua nuk e zvogëlon rolin e prindërve në jetën tënde, por i obligon ata të të sigurojnë realizim përkatës të të gjitha të drejtave.

Cilat dhe çfarë të drejtash ke?

E drejta për jetë. Me vetë lindjen ke të drejtë për jetë. Jeta është e pacenueshme, ndërsa shteti është i obliguar të të sigurojë ekzistencë dhe zhvillim të sigurt.

Duhet të jetosh me prindërit e tu dhe jo i ndarë prej tyre, vetëm nëse gjyqi vendos ndryshe dhe vetëm kur kjo është në interesin tënd më të mirë, përkatësisht nëse prindërit e tu të lëndojnë dhe keqtrajtojnë.

E drejta prindërore dhe kujdesi për ty i përket nënës dhe babait në mënyrë të barabartë dhe ata duhet ta bëjnë më të mirën për ty, kurse ti duhet t'i respektosh dhe t'u ndihmohesh.

Edhe kur nuk jetojnë bashkë prindërit e tu, që të dy kanë obligim të kujdesen për ty dhe bashkë të të rrisin, edukojnë dhe arsimojnë.

Nëse prindërit e tu nuk jetojnë bashkë, ke të drejtë të takohesh me të dy dhe të mbash kontakte personale me prindin me të cilin nuk jeton, përveç nëse një gjë e tillë nuk është e dëmshme për zhvillimin tënd dhe të drejtat e interesat tua.

Qendra për punë sociale kujdeset se si prindërit e tu e ushtrajnë të drejtën prindërore.

Ndalohet dhuna midis anëtarëve të familjes dhe shteti e ka obligim të të mbrojë nëse mbi ty ushtrohet dhunë nga ndonjë anëtarë i familjes.

E drejta për ekzistencë, rritje dhe zhvillim. Duhet të të sigurohen kushte dhe mundësi për ekzistencë normale, rritje, zhvillim dhe standard jetësor përkatës, për çka fëmijët gëzojnë mbrojtje të veçantë jo vetëm nga prindërit por edhe nga institucionet shtetërore.

Nëse prindërit e tu nuk kujdesen për ty ose nuk ke prindër shteti do të të sigurojë kujdes përkatës.

Nëse duhet të adoptohesh patjetër duhet të mbahet llogari se çka është më e mirë për ty.

E drejta e mosdiskriminimit. I ke të drejtat e njëjta si kurse edhe fëmijët e tjerë, pa dallim se: cilës racë i përket, a je mashkull ose femër, në cilën gjuhë flet, cilit religjion ose bashkësi etnike i përket, cilët dhe kush janë prindërit e tu, a janë të pasur ose të varfër, a je i/e aftë ose me aftësi të kufizuara, pavarësisht prejardhjes tënde.

E drejta për interesin më të mirë të fëmijës. Për të gjitha aktivitetet të cilat kanë të bëjnë me ty, të rriturit dhe institucionet duhet të mbajnë llogari ç'është më e mira për fëmijët.

E drejta e pjesëmarrjes dhe mendimit tënd. Ke të drejtë të mendimit tënd për çështje që të përkasin ty.

E drejta për emër, përkatësi etnike dhe shtetësi. Ke të drejtë për emër, përkatësi etnike dhe shtetësi, si dhe ta dish kush je dhe nga je. Lindja dhe emri yt shkruhen në evidencën amzë.

E drejta për arsim. Ke të drejtë dhe detyrim ta kryesh arsimin fillor nën kushte të njëjta mbi bazë të mundësive të barabarta. Shkollimi fillor duhet të jetë pa pagesë. Në shkollë nuk guxon të keqtrajtohesh fizikisht dhe psikikisht, por ke obligim ta respektosh rendin dhe disiplinën. Në shkollë duhet të zhvillohen aftësitë dhe afinitetet tua si dhe talenti dhe të përgatitesh për jetë të përgjegjshme në paqe, tolerancë dhe mirëkuptim.

E drejta për mbrojtjen e shëndetit tënd. Që të jesh fëmijë i shëndoshë dhe i aftë ke të drejtë në mbrojtje shëndetësore të nivelit më të lartë.

E drejta për pushim, kohë të lirë dhe rekreacion. Ke të drejtë për pushim dhe kohë të lirë, në lojë dhe rekreacion dhe të drejtë që lirisht të marrësh pjesë në jetën kulturore dhe artistike.

E drejta dhe liria e besimit fetar. Ke të drejtë lirshëm të deklarohesh për përkatësinë tënde fetare dhe lirshëm ta shprehish besimin, por me këtë nuk duhet t'i cenosh të drejtat dhe ndjenjat e të tjerëve.

E drejta dhe liria për shoqërim. Mundesh lirisht të bashkohesh në shoqata me fëmijë të tjerë përmes të të cilëve mund të realizosh të drejta të caktuara dhe ta shprehësh mendimin tënd për çështje të caktuara që kanë të bëjnë me ju. Por me këtë nuk duhet ta prishni rendin dhe qetësinë publike dhe t'i cenoni të drejtat e të tjerëve.

E drejta e mbrojtje së privatësisë. Ke të drejtë për privatësi tënde. Nuk guxon të të cenohet jeta private dhe familjare, shtëpia apo letërkëmbimet tua dhe askush nuk ka të drejtë të cenojë nderin dhe autoritetin tënd.

E drejta e fëmijës me aftësi të kufizuara në zhvillim. Nëse je fëmijë me aftësi të kufizuara në zhvillim i ke të gjitha të drejtat sikurse edhe fëmijët e tjerë, gëzon jetë të lirë, ke të drejtë në pjesëmarrje aktive në shoqëri dhe kujdes të veçantë si dhe mbrojtje nga shteti.

E drejta e fëmijëve me përkatësi të ndryshme etnike. Si pjesëtar i etnitetit të ndryshëm ke të drejtë që lirisht ta shprehësh, kultivosh dhe zhvillosh identitetin tënd dhe veçoritë e bashkësisë tënde, kurse në shkollimin fillor dhe të mesëm të drejtë shkollimi në gjuhën tënde.

E drejta për mbrojtje të veçantë. Çdo fëmijë ka të drejtë për mbrojtje të veçantë nga:

- keqpërdorimi dhe lënia pas dore;
- konfliktet e armatosura;
- eksploatimi në punë që nuk i përgjigjet moshës tënde;
- droga dhe alkooli;
- abuzimi seksual;
- shitja, trafikimi dhe kidnapimi;
- tortura, sjellja jonjerëzore, brutale, nënçmuese dhe ndëshkuese.

MBROJTJA E TË DREJTAVE TUA NGA AVOKATI I POPULLIT

Nëse organet kompetente nuk veprojnë në bazë të kërkesave për mbrojtjen e të drejtave tua, nëse procedura zgjatë tej mase, cenohen të drejtat tua ose nuk të sigurohet mbrojtje, mund t'i drejtohesh Avokatit të Popullit.

ÇKA ËSHTË AVOKATI I POPULLIT?

Avokati i Popullit është organ i pavarur i përcaktuar me Kushtetutë. Është themeluar në qershor të vitit 1997 dhe vepron sipas Ligjit për Avokatin e Popullit.

KUSH ËSHTË AVOKAT I POPULLIT?

Avokat i Popullit është Ixhet Memeti, jurist i diplomuar me provim të dhënë të jurisprudencës dhe me përvojë pune mbi 20 vjet si: sekretar i Qeverisë, ministër i Drejtësisë dhe gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë.

ÇKA PUNON AVOKATI I POPULLIT?

Avokati i Popullit ndërmjetëson midis qytetarëve dhe organeve të administratës shtetërore, qeverisjes lokale dhe organeve e organizatave me autorizime publike, me qëllim të mbrojtjes së të drejtave të qytetarëve dhe zbatimit të ligjeve.



NË VAZHDIËM TREGONI SE Ç'MJETE JURIDIKE KENI SHFRYTËZUAR (CILIT ORGAN DHE KUR I JENI DREJTUAR)

TË DHËNA TË FAVORSHME: DËSHMIA:

NË ZYRËN E AVOKATIT TË POPULLIT MË PRANOI PERSONI ZYRTAR:

DATA

PARASHTRUESI